

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	---	--

01-12

Datë/a:	28.01.2019
Referencë:	05 Nr. 350/03-4470/19 dt. 09.01.2019
Nga/Od/ From:	Drejtoria e Urbanizmit-Sektorit i Urbanizmit Nazife Krasniqi, zyrtare
Për/ Za/ To:	Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë rr. "Ilir Konushevi" p.n. Prishtinë
CC:	Bedrije Xhymshiti, Shaban dhe Abdil Trkalac dhe Agron Trkalaç, Shefqet Malushaj, Flamur Rexhepi, Hajrije Durmishi, Agim Bunjaku, Sabit dhe Avdullah Mustafa, Ismet Gashi dhe Arbnore Berisha, Fjolla dhe Egzona Thaqi dhe investitori "In On" shpk, me seli në Prishtinë rr. "Lord Bajron", pn
Përmes/Preko/Through:	Lindita Beqiri, u.d. e udhëheqëses së sektorit
CC:	Ardian Olluri, drejtor
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesë për caktim të kushteve teknike

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr. 350/02-4470/19 dt. 09.01.2019, në emër të aplikuesve Salih Berisha, Miradije dhe Bedrije Xhymshiti, Shaban dhe Abdil Trkalac dhe Agron Trkalaç, Shefqet Malushaj, Flamur Rexhepi, Hajrije Durmishi, Agim Bunjaku, Sabit dhe Avdullah Mustafa, Ismet Gashi dhe Arbnore Berisha, Fjolla dhe Egzona Thaqi nga Prishtina, dhe investitori "In On" shpk, me seli në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumëbanesore dhe afariste-Objekti "B", në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7093-1, 7093-2, 7093-3, 7094-0, 7095-0, 7104-0, 7105-1, 7108-3, 7109-5 dhe 7109-6 ZK Prishtinë, me trajtim edhe të pjesës së parcelës kadastrale nr. 7109-7 ZK Prishtinë, me pronar/posedues P.SH. Rrugët KK Prishtinë.

Kjo drejtori, në fazën e shqyrtimit të kërkesës së referuar në paragrafin e parë të kësaj shkrese, ka konstatuar se parcelat kadastrale nr. 7093-1, 7093-2, 7093-3, 7094-0, 7095-0, 7104-0, 7105-1, 7108-3, 7109-5 dhe 7109-6 ZK Prishtinë, për të cilat është kërkuar caktimi i kushteve ndërtimore, shtrihen në kuadër të bllokut urban "A/a_03", të Planit Rregullues "Muhaxhirët" në Prishtinë. Në kufi të parcelave kadastrale në trajtim shtrihet edhe parcela kadastrale nr. 7092-0 ZK Prishtinë, në kuadër të së cilës është e ndërtuar xhamija "Kaderije", ku pas shqyrtimit dhe analizimit të "Vendim" Nr. 68/2016 date 10.10.2016, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për aprovimin e Listës së Trashëgimisë Kulturorë për mbrojtje të Përkohshme, si dhe "Lista e trashëgimise kulturore per mbrojtje te perkohshme (10.10.2016 - 10.10.2017)", ka konstatuar se ndërtesa e xhamisë në fjalë nuk është e përfshirë në listën e referuar më lartë.

Andaj, duke u bazuar në konstatimet e lartshënuara dhe në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë, përkatësisht të nenit 6, pika 6.4, ku thuhet se zona mbrojtëse e monumentit arkitektural është 50 metra nga perimetri i monumentit, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni këtë kërkesë dhe të na njoftoni nëse kjo ndërtesë është e përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme, dhe nëse po, të caktoni kushtet teknike për ndërtim dhe trajtim të asaj zone.

Shtojcë: Kopjen e certifikatës së njësisë kadastrale dhe kopjes së planit për parcelat nr. 7093-1, 7093-2, 7093-3, 7094-0, 7095-0, 7104-0, 7105-1, 7108-3, 7109-5 dhe 7109-6 ZK Prishtinë, projektit konceptual-"zgjdhjes urbane", të propozuar, dhe ekstrakteve nga Plani Rregullues "Muhaxhirët", për bllokun urban "A/a_03" dhe "D/d_02".

I dërgohet: MKRS/Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë, aplikuesve/investitorit, kësaj drejtorie, në lëndë dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

